



Pranuar / Dorezuar Punlyeno/Prilato Received/Delivory	21-12-2020	0	viti qind year
Organ /Njesia Organ./Jednica Org./Unit	Nr. Prot Pr. No	Shtopa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	3250/2020		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.360/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.2591/2020, të datës 13.11.2020, e parashtruar nga [redacted], me adresë banimi Lagjja Arbëria Rr "Ahmet Krasniqi", Nr. 208, Prishtinë, kundër organit të punësimit Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 18.12.2020, mori këtë;

V E N D I M

PËRFUNDON PROCEDIMI administrativ i filluar me ankesën me numër A.nr.360/2020 të datës 13.11.2020 të parashtruar nga ankuesja [redacted] për shkak që objekti i ankesës është bërë i pamundur.

A r s y e t i m

Ankuesja [redacted], sipas akt emërimit të datës 08.06.2018, në pozitën "Drejtoreshë e Departamentit për Administratë dhe Burime Njerëzore", në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, me datën 09.06.2020 ka parashtruar kërkesë me Nr.2020/ADM/147, pranë Komisionit Disiplinor në AACK për inicim të procedurës disiplinore kundër [redacted], në pozitën e punës "Udhëheqëse e njësisë së burimeve njerëzore", me arsyetimin se e njëjta, ka nxjerrë vërtetim, i cili nuk ka qene fare i protokolluar, lidhur me përvojën e punës menaxheriale për [redacted] (ish Kryeshef Ekzekutiv) në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës.

Komisioni Disiplinor i AACK-së, me datën 13.07.2020 ka nxjerrë vendimin me numër Nr.2020/KD/175, me të cilin e ka refuzuar ankesën e ankueses, me

arsyetimin se çështja ne fjale nuk është ne kompetencë te Komisionit Disiplinor, pasi që e njëjta është duke u hetuar nga organet kompetente.

E pakënaqur me vendimin e Komisionit Disiplinor te AACK-se, me datën 06.08.2020 ka parashtruar ankesën me numër Nr.2020/ADM/196 ne Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ne Autoritetin e Aviacionit Civil te Kosovës, mirëpo i njëjti nuk ka nxjerrë vendim lidhur me ankesën e ankueses.

Ankuesja, kundër heshtjes administrative nga Komisioni i Ankesave i AACK-se dhe kundër vendimit te datës 13.07.2020, me numër Nr.2020/KD/175 te Komisionit Disiplinor, me datën 13.11.2020 parashtron ankesë me numër protokolli 2591/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se : ██████████ ne pozitën e Menaxheres së Personelit, kundërligjshëm ka falsifikuar përvojën menaxheriale për ██████████ për pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv te Autoritetit te Aviacionit Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk ka kërkuar fare përgjigje nga organi i punësimit lidhur me ankesën e ankueses të datës 13.11.2020, pasi që Këshilli ka vendosë për të njëjtën ankesë me Vendimin A.nr.336/2020 i datës 20.11.2020.

Administrimi i provave-Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr.336/2020, të datës 28.10.2020, me numër protokolli 2309/2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 03.11.2020; Vendim i datës 12.05.2020 për shkarkimin nga pozita e Drejtorit te Përgjithshëm te ACC-se te ██████████ me shkresat zyrtare drejtuar Qeverise se Kosovës; Vërtetim i datës 06.10.2016 për përvojën menaxheriale te ██████████ Kontratë e punësimit e datës 12.07.2010 për ██████████; Kontrate e punësimit e datës 13.07.2011 për ██████████ Akt emërim i datës 31.07.2012 për ██████████; Shkrese zyrtare e datës 30.10.2018; Memorandum shpjegues për emërimin e Drejtorit te Përgjithshëm te ACC-se i datës 23.11.2018; E-mailat zyrtar te datës 05.07.2018; E-maili zyrtar i datës 04.07.2020; E-maili zyrtar i datës 08.07.2020; Kërkesë e datës 09.06.2020 për inicimin e procedurës disiplinore; Vendim i datës 13.07.2020 i Komisionit disiplinor te ACC-se; Ankese e datës 06.08.2020 drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave te ACC-se; Akt emërim i datës 08.06.2018 i ██████████; Vendim i datës 04.11.2020; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit te emërimit; E-maili zyrtar i datës 13.07.2013; E-maili zyrtar i datës 08.06.2020; E-maili zyrtar i datës 05.06.2020; E-maili zyrtar i datës 04.06.2020; E-maili zyrtar i datës 03.06.2020; Kërkesë për pushim e datës 30.07.2020; Shënim zyrtar i datës 08.01.2020; Njoftim i datës 30.07.2020 i Prokurorisë Themelore ne Prishtine; E-maili zyrtar i datës 23.07.2020; Aktvendim i datës AA.nr.957/2019 i Gjykatës se Apelit te Kosovës; Aktvendim i datës 01.11.2019 i Gjykatës Themelore ne Prishtine.



Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankueses ██████████, është e pa lejuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, gjatë shqyrtimit të ankesës së ankueses me nr. A.nr.360/2020 të datës 13.11.2020 ka konstatuar se lidhur me ankesën e ankueses Këshilli ka nxjerrë vendimin me numër protokolli 2697/2020 të datës 20.11.2020.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se ankuesja me datën 28.10.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për të njëjtin objekt, andaj mbi bazë të kësaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore që të vendoset për përfundim të procedimit administrativ, ashtu siç parashihet me nenin 104 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”*.

Andaj, bazuar në këto rrethana, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin 104 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, vendosi që ankesa e parashtruar nga ankuesja ██████████ të përfundohet procedimi administrativ.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.360/2020, 18.12.2020

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli
Procesmbajtëse

Arben MEHMETI

Arben Mehmeti
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses ██████████
- Drejtorit të Përgjithshme të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së

